

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 33, datë 31.03.2026

PËR
MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT “INSIG JETË” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë të Administrimit të Riskut dhe Modeleve Financiare, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike dhe matematike të shoqërisë “INSIG JETË” SH.A., siç paraqiten në 31 dhjetor 2025, sipas përlogaritjes së shoqërisë.
2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2025 të provigjoneve teknike dhe matematike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:

Provigjonet teknike dhe matematike në 31 dhjetor 2025	Lekë
Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total	440,680,444
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	<i>49,410,283</i>
Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total	391,270,161

3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI